



REPUBLIKA E SHqipëRIE
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

NËNTOR 2022

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Nëntor 2022

© Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2022
Drejtoria e Analizave Makroekonomike dhe Statistikave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë

www.financa.gov.al

E-mail: Dajana.Metolli@financa.gov.al

Përmbajtja

VEÇORITË KRYESORE _____ **2**

ZHVILLIMET EKONOMIKE _____ **3**

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit _____ 3
2. Kursi mesatar i Këmbimit _____ 4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave _____ 5
4. Bilanci i Pagesave _____ 6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar _____ 7
6. Kredia për Ekonominë _____ 8
7. Oferta e Parasë _____ 9
8. Depozitat sipas burimeve _____ 10

SEKTORI FISKAL _____ **11**

1. Buxheti i Konsoliduar _____ 11
2. Të Ardhurat Sipas Burimeve _____ 12
3. Financimi i Bilancit Fiskal _____ 13

ANEKSI STATISTIKOR _____ **13**

Veçoritë Kryesore


- Indeksi i çmimeve të konsumit në muajin Nëntor 2022, arriti në 110.9;
- Norma vjetore e inflacionit për muajin Nëntor 2022 ishte 7.9 përqind;
- Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin Nëntor 2022 ishte 115.15 lekë për dollarë dhe 117.12 lekë për euro;
- Normat e interesit të depozitave në lekë gjatë muajit Nëntor 2022 shënuan kuotën 1.03 përqind për ato 12-mujore; 0.55 përqind për depozitat 6-mujore; 0.50 përqind për depozitat 3-mujore dhe 2.34 përqind për depozitat 1-mujore;
- Normat e interesit për huatë në lekë ishin 7.75 përqind për huatë 12-mujore dhe 5.73 përqind për ato 6-mujore;
- Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1,643,736 milionë lekë në muajin Nëntor, duke shënuar një rritje prej rreth 6.3 përqind, krahasuar me një vit më parë;
- Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e tretë të 2022 rezultoi me rritje të mjeteve valutore (rezervës), duke shënuar vlerën 94.10 milionë euro
- Situata Buxhetore për periudhën Nëntor 2022 rezultoi me një sufiçit të përgjithshëm prej rreth 9,224 milion lekë, ndërkohë që ishte planifikuar një defiçit prej 66,950 milion lekë.
- Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Nëntor 2022, arritën në rreth 522.866 miliardë lekë ose afërsisht 0.6 % më shumë se plani për këtë periudhë.
- Shpenzimet gjithsej gjatë së njëjtës periudhë, arritën në rreth 513.642 miliardë lekë ose rreth 12.5% më pak se shpenzimet e planifikuara për këtë periudhë.

Zhvillimet Ekonomike

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Inflacioni vjetor për muajin Nëntor 2022 ishte 7.9%, një vit më parë ky ndryshim ishte 3.1%. Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Nëntor 2022, krahasuar me Tetor 2022 është -0.3%. Një muaj më parë, Tetor 2022, IÇK shënoi rritje mujore gjithashtu prej 0.4%.

Referuar një viti më parë, Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin Nëntor 2021 shënoi rritje mujore prej 0.2%, në krahasim me muajin paraardhës.



Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, grupet të cilat patën kontributin më të lartë në inflacionin e përgjithshëm ishin:

- Ushqime dhe pije joalkolike me rritje vjetore të çmimit prej +14.7%, duke kontribuar me +5.12 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +7.9%.
- Qera, ujë lëndë djegëse dhe energji me rritje vjetore të çmimit prej +3.1%, duke kontribuar me +0.60 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +7.9%.
- Transport me rritje vjetore të çmimit prej +9.6%, duke kontribuar me +0.58 pikë

përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +7.9%.

- Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje, me rritje vjetore +6.2%, duke kontribuar me +0.47 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +7.9%.
- Pije alkolike dhe duhan me rritje vjetore të çmimit prej +5.8%, duke kontribuar me +0.29 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +7.9%.
- Hotele, kafene dhe restorante me rritje vjetore të çmimit prej +6.1%, duke kontribuar me +0.28 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +7.9%.

Tab - 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)


VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2021	0.4	1.1	1.2	1.4	1.8	1.6	2.2	2.4	2.5	2.4	3.1	3.7
2022	3.7	3.9	5.7	6.2	6.7	7.4	7.5	8	8.1	8.3	7.9	

Burimi: INSTAT

2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin Nëntor 2022, arriti në 117.12 lekë/euro, duke shënuar rënie në vlerë me 0.11 përqind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit Nëntor, një euro u këmbye me 116.86 lekë.

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin Nëntor 2022 arriti në 115.15 lekë/dollarë duke shënuar rënie në vlerë me 3.45 përqind kundrejt një muaji më parë. Në fund të muajit Nëntor, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 112.72 lekë/dollarë.



Në krahasim me muajin Nëntor të vitit të kaluar, pas një periudhe të konsiderueshme forcimi, rezulton se monedha shqiptare ka pësuar një mbiçmim ndaj monedhës europiane në masën 4.11 përqind, ndërsa kundrejt dollarit amerikan rezulton se është nënçmuar në masën 7.71 përqind. Në përgjithësi, forcimi i lekut në vitet e fundit ka ardhur si pasojë e konjunkturave të jashtme, për shkak të krizave të njëpasnjëshme, nga pandemia botërore Covid-19 deri tek lufta në Ukrainë.

Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan, shënoi një nivel mesatar rreth 0.98 dollarë/euro për muajin Nëntor 2022.

Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë kësaj periudhe përmendim: qendrueshmëria e kursit të këmbimit për shkak të ndërhyrjes së shpejtë të BSH-së, stabiliteti i situatës makroekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasiteti në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga BSH-ja, etj.

3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit Nëntor 2022, normat e interesit të depozitave me afat 12 dhe 1 mujore shënuan vlerat më të larta prej 1.03 dhe 2.34 përqind përkatësisht, pasuar nga ato me afat 6 dhe 3 mujore që arritën kuotën përkatësisht 0.55 dhe 0.50 përqind.


Krahasuar me një muaj më parë, normat e interesit të depozitave me afat maturimi 12,6 dhe 1 mujore kanë shënuar rritje përkatësisht me 0.12, 0.01 dhe 0.47 pikë përqindje, ndërsa normat e interesit 3 mujore kanë shënuar rënie me 0.03 pikë përqindje.

Referuar një viti më parë, normat e interesit të depozitave me afat maturimi 12, 6, 3 dhe 1 mujore kanë shënuar rritje vjetore përkatësisht prej 0.57, 0.16, 0.38 dhe 1.91 pikë përqindje.

Normat e Interesit të huave 6 dhe 12 mujore, gjatë muajit Nëntor 2022, arritën përkatësisht kuotën prej 5.73 dhe 7.75 përqind. Në krahasim me një muaj më parë, normat e interesit të huave 12 mujore kanë shënuar rritje me 1.10 pikë përqindje dhe nomat e interesit 6 mujore kanë shënuar rënie me 1.10 pikë përqindje. Krahasuar me një vit më parë normat e interesit të huave 12 mujore kanë shënuar rritje me 2.10 pikë përqindje dhe normat e interesit 6 mujore kanë shënuar rënie vjetore përkatësisht me 0.88 pikë përqindje.

Normat e interesit të bonove të thesarit 12 mujore për muajin Nëntor 2022 patën rritje vjetore me 4.10 pikë përqindje.


Fig. 3



Normat e interesit për depozitat (%)

Burimi: Banka e Shqipërisë

Fig-4



Normat e interesit për huatë dhe bonot

Burimi: Banka e Shqipërisë



4. Bilanci i Pagesave

Në nëntëmujorin e parë të vitit 2022, Bilanci i Pagesave (BP) shënoi rënie, në vlerën -58.1 milion euro, nga +209.5 milion euro që ishte në nëntëmujorin e parë të 2021. Ndërsa vetëm për tremujorin e tretë të 2022, BP shënoi vlerën +94.2 milion euro, krahasuar me tremujorin e tretë të 2021 që shënoi vlerën +252.3 milion euro.

Për nëntëmujorin e parë të vitit 2022, defiqiti i llogarisë korente u ngushtua në -621.2 milion euro krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë që ishte -625.8 milion euro. Ndërsa, vetëm për tremujorin e tretë të 2022, llogaria korente e zgjeroi deficitin në -166.0 milion euro, krahasuar me tremujorin e tretë të 2021 që ishte -105.6 milion euro.

Në nëntëmujorin e parë të vitit 2022, Llogaria financiare dhe kapitale u ngushtua në vlerën +581.9 milion euro krahasuar me +733.9 miliard euro në nëntëmujorin e parë 2021. Gjithashtu, vetëm për tremujorin e tretë të 2022, llogaria financiare dhe kapitale u ngushtua në +131.5 mln euro, krahasuar me +253.5 mld euro në tremujorin e tretë të 2021.

Në nëntëmujorin e parë të vitit 2022, Investimet e Huaja Direkte (IHD) u zgjeruan në vlerën +984.3 milionë euro ose +34.8%, krahasuar me +730.0 milion euro në nëntëmujorin e parë 2021. Gjithashtu, vetëm për tremujorin e tretë të 2022, IHD regjistruan vlerën +344.3 mln euro ose +32.2%, krahasuar me +260.4 mln euro në tremujorin e tretë të 2021.





5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit Nëntor 2022, sistemi bankar ka shënuar rënie të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 17,552 milionë lekë krahasuar me muajin Nëntor të vitit 2021. Kjo rënie ka ardhur kryesisht si pasojë e rënies së mjeteve valutore neto të Bankës Qëndrore me 24,890 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë mjetet valutore neto kanë shënuar rënie me 13,991 milionë lekë, ku më së shumti ka kontribuar rënia mujore prej 8,682 milionë lekë e Bankave Paradevizituese.

Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1,643,736 milionë lekë në muajin Nëntor 2022, duke shënuar një rrije prej rreth 97,892 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pra një rritje vjetore prej 6.3 përqind.

Në muajin Nëntor 2022, sistemi bankar rezulton me rënie mujore prej 12,896 milionë lekë.





6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin Nëntor 2022 arriti në rreth 719.879 milionë lekë. Bilanci i kredisë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shënoi rritje me vlerë 61.368 milionë lekë, ose rritje me rreth 9.32 përqind. Struktura e kredisë sipas monedhave është e balancuar mes monedhës kombëtare (51.8%) dhe monedhës të huaja (48.2%).

Gjatë muajit Nëntor 2022, zëri “Korporata të tjera jo-financiare”, zuri peshën më të lartë të totalit të kredive, me rreth 58.2 përqind ose 418.805 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 36.3 përqind ose rreth 261,652 milionë lekë. Zërat “Korporata jo financiare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 3.3 dhe 2.10 përqind apo 23.756 dhe 15.449 milionë lekë.


Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës së huaj për muajin Nëntor 2022, zëri “Korporata të tjera jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 69.26 përqind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 24.84 përqind. “Korporata të tjera financiar” dhe “Korporata jofinanciare publike” kontribuojnë përkatësisht me 2.04 dhe 3.85 përqind secili.



7. Oferta e Parasë

Paraja jashtë Korporatave Depozituese arriti në rreth 375.699 milionë lekë në fund të muajit Nëntor 2022. Raporti i Parasë jashtë Bankave me M3 në Nëntor 2022 ka shënuar rritje mujore prej 0.18 përqind dhe rënie vjetore prej 0.43 përqind, duke arritur nivelin 22.86 përqind. Raporti i Parasë jashtë Bankave me Depozitat ka shënuar rrije mujore prej 0.30 përqind, dhe rënie vjetore prej 0.72 përqind, duke shënuar nivelin 29.6 përqind.

Fig-11




Raportet e parasë jashtë bankave me M3 & Depozitat

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në valutë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin Nëntor 2022, kanë shënuar rritje vjetore prej 69.7667 milionë lekë, e sjellë kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 74.7 përqind të depozitave në valutë. Gjithashtu depozitat në Lekë gjatë muajit Nëntor 2022 shënuan rritje prej 12.328 milionë lekë në krahasim me muajin Nëntor 2021. Sektori i Individëve në lekë ka zënë rreth 79.4 përqind të depozitave në lekë.

Fig-12




Raporti i Depozitave ndaj M3

Burimi: Banka e Shqipërisë

8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit Nëntor 2022, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 79.4 përqind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 14.6 përqind dhe nga “Korporata jo-financiare publike” me 3.5 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 74.8 përqind dhe rreth 22.7 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 76.7 përqind e totalit.

Fig-13




Rritja e stokut total të depozitave

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në total, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 973.203 milionë lekë të depozitave totale. Ato ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (243.990 milionë lekë), “Korporata të tjera financiare” (25.020 milionë lekë), dhe “Korporata jofinanciare publike” (24.006 milionë lekë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth (1.817 milionë lekë) në totalin e depozitave. Gjatë muajit Nëntor 2022, niveli i përgjithshëm i depozitave arriti vlerën rreth 1.268.037 milionë lekë.

Fig-14



Përberja e depozitave Nëntor'22

Burimi: Banka e Shqipërisë


Krahasuar me një muaj më parë niveli i depozitave shënoi rënie prej rreth 12.864 milionë lekë. Ndërsa, krahasuar me një vit më parë totali i depozitave ka shënuar rritje me 82.094 milionë lekë.

Sektori Fiskal

1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën Nëntor 2022 janë mbledhur rreth 522.866 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 513.642 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 426.782 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe rreth 185.304 miliardë lekë në shpenzime për fonde speciale.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 356.810 miliardë lekë. Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor janë rreth 25.838 miliardë lekë. Të ardhurat nga fondet speciale janë rreth 112.324 miliardë lekë (ose rreth 4 % më shumë se plani i periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 19.908 miliardë lekë (ose rreth 0.2 % më shumë se plani i periudhës)



Nga totali i shpenzimeve korrente prej 426.782 miliardë lekë 76.755 miliardë lekë (17.98% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 38.795 miliardë lekë (9.1 % e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime interesi, 50.370 miliardë leke (11.80% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 1,359 milion lekë (0.31% e totalit të shpenzimeve korrente) për subvencione, 185.304 miliardë lekë (43.41%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, 48.733 miliardë lekë (11.42% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzimet e qeverisjes vendore, dhe 25.465 miliardë lekë (5.97% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime të tjera.

2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar - Nëntor 2022 ishin rreth 476.187 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 494.972 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 19.908 miliardë lekë.

Tab - 2	Të ardhurat gjatë muajit Janar – Nëntor 2022 (mld Lekë) Revenues during January - November 2022 (in billion ALL)			
	Burimi (Source)	November '22 Nëntor '22	November '22 Nëntor '22	November '22 Nëntor '22
	TVSH (VAT)	176,799	144,274	+ 22.5
	Taksa doganore (Custom Tax)	7,647	6,701	+ 14.1
	Akcizat (Excise)	48,671	46,608	+ 4.4
	Tatimi mbi fitimin (Profit Tax)	40,909	30,670	+ 33.4
	Tatim mbi të ardhurat personale (TAP) / (Income Tax)	41,146	36,074	+ 14.1
	Taksat nacionale (National Tax)	41,638	38,484	+ 8.2

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Statistikat Fiskale: Nëntor- 2022

Source: Ministry of Finance and Economy, Fiscal Statistics: November - 2022

3. Financimi i Bilancit Fiskal

Bilanci fiskal prej 9.224 miliardë lekë gjatë periudhës Janar – Nëntor 2022, u përdor kryesisht për financim të huaj.

Për periudhën Janar-Nëntor 2022, disa nga treguesit kryesorë fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 522.866 miliardë lekë,
- Realizimi i shpenzimeve në masën 513.642 miliardëlekë.

Në realizimin e të ardhurave për periudhën Janar - Nëntor 2022, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat tatimore, të cilat arrijnë shifrën e 494.972 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 426.782 miliardë lekë dhe shpenzimet për fonde speciale me rreth 185.304 miliardë lekë.

Aneksi Statistikor

Tab - 1 Indeksi i çmimeve të konsumit
Consumer price index (in %)

Muaji	Mujor (Monthly)							Mesatar Mujor (Monthly Average)							Vjetor (Annual)					Month		
	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2016	2017	2018	2019	2020		2021	2022
Janar	0.9	1.5	1.5	1.6	1.9	1.3	1.3	0.9	1.5	1.5	1.6	1.9	1.3	1.3	1.5	2.8	1.7	1.9	1.5	0.4	3.7	January
Shkurt	1.1	0.5	0.8	0.6	0.4	1.1	1.3	1.0	1.0	1.1	1.1	1.1	1.2	1.3	0.2	2.2	2.1	1.7	1.2	1.1	3.9	February
Mars	0.5	0.4	0.3	-0.3	0.6	0.7	2.4	0.8	0.8	0.9	0.6	0.9	1.0	1.7	0.3	2.1	2.0	1.1	2.1	1.2	5.7	March
Prill	-0.4	-0.6	-0.5	-0.2	-0.4	0.2	0.7	0.5	0.5	0.5	0.4	0.6	0.8	1.4	0.3	1.9	2.1	1.4	1.9	1.9	6.2	April
Maj	-1.2	-1.2	-1.2	-1.0	-0.8	-0.9	-0.5	0.2	0.1	0.2	0.1	0.3	0.5	1.0	0.7	2.0	2.1	1.5	2.1	1.8	6.7	May
Qershor	-0.6	-0.4	-0.1	-0.3	-0.6	-0.8	-0.1	0.04	0.0	0.1	0.1	0.2	0.3	0.9	1.2	2.2	2.4	1.3	1.8	1.6	7.4	June
Korrik	0.0	-0.1	-0.3	-0.1	-0.5	0.1	0.2	0.04	0.0	0.1	0.0	0.1	0.2	0.8	1.9	2.0	2.3	1.5	1.4	2.2	7.5	July
Gusht	0.9	0.4	0.4	0.3	0.2	0.4	0.8	0.14	0.1	0.1	0.1	0.1	0.3	0.8	2.0	1.6	2.2	1.5	1.3	2.4	8.0	August
Shtator	0.4	0.4	0.2	0.1	0.4	0.5	0.6	0.17	0.1	0.1	0.1	0.1	0.3	0.7	1.8	1.6	2.1	1.3	1.5	2.5	8.1	September
Tetor	-0.2	0.0	-0.2	-0.2	0.2	0.1	0.4	0.04	-0.1	-0.1	-0.1	0.1	0.3	0.7	1.8	1.6	2.1	1.3	2.0	2.4	8.3	October
Nëntor	0.1	-0.1	-0.2	-0.2	-0.5	0.2	-0.3	0.12	0.1	0.1	0.0	0.1	0.3	0.6	1.9	1.7	1.8	1.4	1.6	3.1	7.9	November
Dhjetor	0.1	-0.1	-0.2	-0.2	0.3	0.8		0.05	-0.1	-0.1	-0.1	0.1	0.3		1.9	1.7	1.8	1.4	1.1	3.7		December

Burimi : INSTAT

Source : INSTAT

Tab - 2 Kursi i këmbimit
Exchange rate

Monedha	2022																	Currency	
	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor		Nëntor
								January	February	March	April	May	June	July	August	September	October	November	
Mesatarja e periudhës:																			<i>Average of period</i>
USD	125.96	124.15	119.10	107.99	109.85	108.65	103.68	107.32	107.02	111.58	111.69	113.94	113.25	115.29	115.47	118.01	119.26	115.15	USD
EURO	139.74	137.36	134.15	127.59	123.01	123.77	122.37	121.49	121.32	122.96	121.00	120.47	119.80	117.47	116.97	116.99	117.25	117.12	EURO
Fundi i periudhës																			<i>In the end of period</i>
USD	125.79	128.17	111.10	107.82	108.64	100.84	106.54	108.18	108.52	109.28	114.56	112.51	114.22	114.46	117.26	118.85	118.76	112.72	USD
EURO	137.28	135.23	132.95	123.42	121.77	123.70	120.76	120.90	121.32	121.62	121.10	120.75	119.13	116.78	117.19	116.60	118.07	116.86	EURO

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 3 Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)
Annual Interest Rates (in ALL)

Në përqindje					2022	2022	2022	2022	2022	2022	2022	2022	2022	2022	2022	In percent
	2018	2019	2020	2021	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	
Norma e depozitave																Deposits rates
12-M	0.73	0.49	0.41	0.47	0.44	0.46	0.46	0.80	0.75	0.65	0.69	0.53	0.92	0.91	1.03	12-M
6-M	0.59	0.42	0.35	0.35	0.35	0.27	0.30	0.34	0.50	0.42	0.38	0.46	0.59	0.54	0.55	6-M
3-M	0.28	0.23	0.21	0.15	0.15	0.13	0.16	0.39	0.23	0.22	0.49	0.26	0.37	0.53	0.50	3-M
1-M	0.76	0.66	0.49	0.41	0.39	0.38	0.48	0.79	0.90	0.92	1.03	1.42	1.58	1.87	2.34	1-M
Norma e huasë																Lending rates
12-M	5.66	6.25	6.05	5.91	6.56	6.40	6.01	6.69	6.57	5.70	5.81	6.50	6.55	6.65	7.75	12-M
6-M	8.12	7.07	6.28	6.16	5.82	6.78	6.55	9.37	6.21	5.56	5.61	5.02	6.22	6.83	5.73	6-M
Norma e letrave me vlerë																Securities rates
Bono thesari 1/																Treasury bills 1/
3-M	-	-	-		0.96	0.85	1.00	1.40	1.26	1.52	1.69	1.90	2.25	2.78	2.91	3-M
6-M	-	-	-			1.21	1.24	1.75	1.85	-	2.10	2.37	2.88	3.83	4.57	6-M
12-M	1.43	1.69	1.77	1.60	1.58	1.58	1.87	1.96	2.16	2.50	2.78	3.26	4.07	5.00	5.79	12-M

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

TREGUESIT FISKAL SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2022

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2022

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

Nr.	E M È R T I M I	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	Korrik July	Gusht August	Shtator September	Tetor October	Nëntor November	ITEMS
	TOTALI TË ARDHURAVE	45,726	87,679	139,408	188,172	233,421	279,410	327,541	376,711	426,198	476,187	522,866	TOTAL REVENUE
I.	Të ardhura nga ndihmat	189	1,000	1,782	2,167	2,707	2,825	3,673	4,221	4,712	7,574	7,986	Grants
II.	Të ardhura tatimore	44,054	83,482	132,519	178,083	220,614	264,719	310,603	357,975	405,433	451,079	494,972	Tax Revenue
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	30,038	57,882	95,732	126,505	156,870	188,719	221,461	257,635	292,809	324,683	356,810	From tax offices and customs
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	15,075	29,586	45,639	60,821	75,943	91,129	107,876	125,498	143,907	161,076	176,806	V.A.T
2	Tatimi mbi Fitimin	1,652	3,992	14,277	17,949	20,765	24,914	27,437	30,030	33,950	36,694	40,901	Profit Tax
3	Akcizat	3,495	7,463	11,367	15,087	19,476	24,184	29,106	34,713	39,374	43,878	48,671	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	4,028	7,099	10,569	14,666	18,264	21,612	25,685	30,633	34,088	37,714	41,149	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	5,324	8,714	12,152	15,610	19,294	22,975	26,636	31,273	35,215	38,371	41,635	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	464	1,029	1,728	2,372	3,128	3,905	4,720	5,488	6,275	6,950	7,647	Customs Duties
II.2	Të ardhura nga Pushteti Vendor	3,166	5,790	7,753	11,546	14,098	16,852	18,736	20,023	22,145	24,098	25,838	Revenues from Local Gov.
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërsesat)	277	557	1,065	2,208	2,958	3,659	4,148	4,604	5,028	5,396	5,674	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	9	15	25	31	38	40	44	53	57	63	66	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	2,880	5,218	6,664	9,307	11,102	13,153	14,544	15,367	17,061	18,639	20,098	Local Taxes
II.3	Të ardh nga fondet speciale	10,850	19,811	29,033	40,032	49,645	59,147	70,406	80,317	90,479	102,298	112,324	Social Ins. contributions
1	Sigurimi Shoqëror	9,312	17,055	25,008	34,393	42,707	50,901	60,527	69,105	77,817	87,933	96,675	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetsor	1,500	2,651	3,831	5,352	6,579	7,801	9,361	10,621	11,998	13,631	14,852	Health insurance
3	Të ardhura për kompensim në vlerë të pronarëve	38	105	194	287	360	446	518	592	664	735	796	Compensation income in the value of owners
III.	Të ardhura Jotatimore	1,484	3,197	5,108	7,922	10,101	11,866	13,265	14,515	16,052	17,534	19,908	Nontax Revenue
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	942	2,058	3,325	5,309	6,772	7,765	8,549	9,145	9,998	10,778	11,493	Income of budgetary institutions
3	Tarifat shërbimeve	188	354	555	784	996	1,297	1,508	1,728	2,004	2,331	2,645	Utility fees
4	Të tjera	354	785	1,227	1,829	2,333	2,803	3,205	3,626	4,035	4,407	5,752	Others
	TOTALI I SHPENZIMEVE	32,599	68,920	117,523	169,201	214,131	264,210	312,284	362,394	409,951	465,750	513,642	TOTAL EXPENDITURE
I.	Shpenzime Korrente	31,895	67,325	104,161	145,133	183,265	226,330	265,657	303,436	343,028	385,483	426,782	Current Expenditures
I.1	Personeli	6,740	13,486	20,333	27,169	34,079	40,992	48,115	55,205	62,051	69,024	76,755	Personnel expenditures
1	Paga	5,781	11,564	17,428	23,279	29,203	35,084	41,068	47,140	52,991	58,930	65,450	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	952	1,906	2,859	3,831	4,787	5,791	6,770	7,738	8,696	9,668	10,713	Social insurance contributions
3	Arsimi i lartë nga të ardhurat e veta	6	17	46	60	89	118	278	327	364	426	593	Higher education from its own income
I.2	Interesat	5,037	7,446	11,029	13,668	15,161	19,117	24,221	26,416	29,959	34,570	38,795	Interest
1	Të Brendshme	4,010	5,907	8,947	10,895	11,775	12,599	16,651	18,241	21,143	23,077	23,729	Domestic
2	Të Huaja	1,027	1,539	2,082	2,773	3,387	6,519	7,570	8,175	8,817	11,494	15,067	Foreign
I.3	Shpenzime Operative Mirëmbajtje	1,732	5,776	9,920	15,048	20,169	25,512	29,459	33,356	38,525	45,181	50,370	Operational & Maintenance
I.4	Subveconet	74	167	252	329	412	483	570	702	881	1,004	1,359	Subsidies
I.5	Shpenzime për fonde speciale	14,449	30,212	45,532	64,692	82,264	101,839	117,968	135,983	152,556	169,379	185,304	Social Insurance outlays
1	Sigurime Shoqërore	10,645	21,559	33,340	46,934	60,422	75,499	87,938	101,641	114,273	126,803	138,852	Social insurance
2	Sigurime Shëndetsore	3,129	7,979	11,515	16,531	20,616	25,115	28,804	33,118	37,060	41,357	45,219	Health insurance
3	Fondi i kompensimit të pronarëve	674	674	677	1,227	1,226	1,226	1,226	1,224	1,222	1,219	1,234	Owners' Compensation Fund
I.6	Shpenzime per Buxhetin Vendor	2,457	6,764	11,130	15,671	20,089	24,735	29,421	33,591	38,474	43,261	48,733	Local budget expenditure
I.7	Shpenzime të tjera	1,407	3,473	5,964	8,555	11,090	13,651	15,902	18,184	20,581	23,062	25,465	Other expenditures
1	Pagesa e Papunesisë	45	109	175	233	297	361	420	480	552	616	674	Unemployment insurance benefits
2	Ndihma Ekonomike	1,162	2,891	5,017	7,258	9,463	11,598	13,492	15,314	17,159	19,112	21,094	Economic Aid
3	Bonusi i lindjeve	200	400	700	900	1,100	1,400	1,600	2,000	2,300	2,600	2,800	Birth bonus
I.8	Transferime Kapitale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	Capital transfers
II	Fondi Rezerve, Kontigjenca	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	Reserve fund/contingency
III	Shpenzime Kapitale	703	1,596	7,986	16,161	22,959	29,972	38,720	43,051	51,015	56,360	62,952	Capital expenditures
1	Financimi Brendshëm	0	175	2,653	5,620	8,213	11,942	18,015	20,290	25,132	28,117	32,928	Domestically financed
2	Investime nga të ardhurat e Arsimit të Lartë	1	26	97	173	262	354	474	495	538	576	611	From higher education system's own revenues
3	Financimi Huaj	703	1,395	4,043	5,090	6,989	8,178	9,502	10,389	11,669	13,067	14,262	Foreign financed
IV	Fondi i rindertimit	0	0	1,193	5,278	7,494	9,497	10,729	11,877	13,676	14,599	15,151	Reconstruction fund
V.	DEFICITI	13,127	18,759	21,885	18,971	19,290	15,201	15,256	14,316	16,247	10,437	9,224	CASH BALANCE
V.1	FINANCIMI DEFICITIT	-13,127	-18,759	-21,885	-18,971	-19,290	-15,201	-15,256	-14,316	-16,247	-10,437	-9,224	CASH BALANCE FINANCING
V.2	Brendshëm	-12,150	-14,220	-21,203	-12,981	-12,307	-14,037	-12,982	-11,812	-11,455	-1,968	431	Domestic
1	Të ardhura nga privatizimi	44	55	59	98	131	133	160	161	162	164	167	Privatization receipts
2	Hua-marrje e brendshme	2,604	-4,986	-1,789	-8,710	-7,124	-2,895	-4,935	-7,018	4,047	4,063	10,214	Domestic new borrowing (net)
3	Të tjera	-14,798	-9,290	-19,473	-4,369	-5,314	-11,275	-8,206	-4,955	-15,665	-6,195	-9,949	Others
V.3	I huaj	-977	-4,539	-682	-5,990	-6,984	-1,164	-2,274	-2,504	-4,792	-8,469	-9,656	Foreign
1	Hua afatgjatë(e marrë)	420	2,490	3,472	3,821	5,162	6,193	6,886	6,895	7,355	7,900	8,266	Long-term foreign borrowing (gross)
2	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	114	-2,048	-1,132	-814	-752	-674	-850	-476	-119	-63	381	Chang. of stat. Account
3	Ripagesat	-1,511	-4,981	-8,184	-14,445	-17,179	-20,589	-22,216	-25,759	-28,864	-33,142	-35,420	Repayments
4	Mbështetje Buxhetore	0	0	5,161	5,448	5,786	13,906	13,906	16,837	16,837	16,837	17,117	Budgetary Support

Burimi : Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Source : Ministry of Finance and Economy

* "Ndryshimi i gjendjes së arkës" përfaqëson ndryshimin e Depozitës së Financimeve të Huaja

Tabela e investimeve 2022

Table of investments 2022

Të dhëna progresive (Progressive Data)

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	
	January	February	March	April	May	June	July	August	September	October	November	
Financim i brendshëm	-12,150	-14,220	-21,203	-12,981	-12,307	-14,037	-12,982	-11,812	-11,455	-1,968	431	Domestic financing
<i>Në %</i>	92.6	75.8	96.9	68.4	63.8	92.3	85.1	82.5	70.5	18.9	-4.7	<i>In %</i>
Financim i huaj	-977	-4,539	-682	-5,990	-6,984	-1,164	-2,274	-2,504	-4,792	-8,469	-9,656	Foreign financing
<i>Në %</i>	7.4	24.2	3.1	31.6	36.2	7.7	14.9	17.5	29.5	81.1	104.7	<i>In %</i>
Totali	-13,127	-18,759	-21,885	-18,971	-19,290	-15,201	-15,256	-14,316	-16,247	-10,437	-9,224	Total
<i>Në %</i>	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	<i>In %</i>

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Source: Ministry of Finance and Economy

Tab - 6 TË ARDHURAT DOGANORE DHE TATIMORE 2022
CUSTOMS AND TAX REVENUES 2022

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)
